

V E N D I M
Nr.517, datë 1.11.1993

PËR ULJEN E KUFIRIT TË PERIUdhËS SË SIGURIMIT

Në mbështetje të nenit 98 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale dhe të Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare e Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Punonjësve (gra) që punojnë në punët që parashikohen në kapitullin XI "Punët në industrinë tekstile" të pasqyrës nr.2, të punëve që hyjnë në kategorinë e dytë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.526, datë 20.12.1958 "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni", t'u njihet e drejta e daljes në pension të parakohshëm sipas nenit 97 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", kur kanë plotësuar jo më pak se 22 vjet e 6 muaj në këto profesione.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.10.1993

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi